

## Specifikimet teknike

### Të përgjithshme

- Kompania private duhet të kryejë grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të prodhuara në njësitë administrative Velipojë dhe Dajç dhe të realizojë depozitimin e tyre në landfillin e Bushatit.
- Është parashikuar që në njësitë administrative Velipojë dhe Dajç cdo ditë prodhohen respektivisht 1.7 dhe 1,45 ton mbetje, ndërkohë që në Velipojë përgjatë sezonit turistik ka shtesë prej 17,72 ton mbetje në ditë.
- Përveç grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, kompania duhet të sigurojë edhe grumbullimin e diferencuar të rrymave të caktuara të mbetjeve (plastikë, karton/leter dhe material ambalazues) nga bizneset, baret dhe hotelet të lokalizuara në zonën e plazhit në qendër të Velipojës.
- Gjithashtu kompania duhet të kryejë edhe fshirjen dhe larjen e rrugëve të lokalizuara në zonën e plazhit në qendër të Velipojës sipas specifikimeve teknike të detajuara më poshtë.

### Prodhimi I mbetjeve

Elementi kryesor I llogaritjes se planifikimit eshte norma e prodhimit te mbetjeve.. Gjithashtu element I rendesishem per percaktimin e sasise ditore te mbetjeve eshte dhe numri I popullsisë. Ne tabelen e meposhtme po japim prodhimin mesatar ditor dhe vjetor te mbetjeve per njesite administrative respective .

Nj.Administrative	Banore		Sasia e prodhuar e mbetjeve			
	Gj, Civile	Census	Norma kg/dite	Ton /dite	Ton /vite	Ton/9 muaj
Nj.A Velipoje	9536	5031	0.34	1.7	624	
Nj.A Dajç	9083	3885	0.37	1.45	532	
Plazhi Velipoje		39500	0.45	17.72	1772 (100 dite)	
<b>T O T A L I</b>				20 ton/dite		

Megjithëse këto llogaritje janë të bazuara mbi disa supozime dhe saktësia e tyre konsiderohet si mesatare, sërisht ato janë konsultuar me ekspertë dhe përfaqësues të bashkisë Shkodër si dhe punonjës të kompanisë private për t'i krahasuar këto shifra me eksperiencën praktike.

### Numri i kontenerëve të nevojshëm për NjA Velipojë dhe Dajç

	<i>Sasia mesatare vjetore</i>	<i>Sasia mesatare ditore</i>	<i>Frekuenca e propozuar</i>	<i>Densiteti mesatar i mbetjeve</i>	<i>Kapaciteti i kontenierëve</i>	<i>Koeficienti i mbushjes</i>	<i>Nevoja per konteniere</i>
	ton/vit	ton/ dite	dite/ jave	ton/m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	%	copë
<b>Velipojë</b>	624	1.7	2	0.15	1.1	85	<b>130</b>
<b>Dajç</b>	532	1.45	2	0.15	1.1	85	<b>57</b>
<b>Velipoja Plazh (100 dite)</b>	1685	16.85	14	0.15	1.1	85	<b>78</b>

<b>Total</b>	<b>4,202</b>	<b>25.13</b>	<b>261</b>
--------------	--------------	--------------	------------

Nga tabela e mësipërme duket qartë që numri i nevojshëm i kontenierëve për NjA varet shumë nga frekuenca e grumbullimit të mbetjeve. Literatura sugjeron që për një NjA e cila prodhon më shumë se 2 ton mbetje në ditë të ketë një frekuencë për grumbullimin e mbetjeve të paktën dy here në javë. Ky është rasti për të dyja NjA Velipojë dhe Dajc. Ndërkohë që për NjA Velipojë gjatë sezonit turistik (mesatarisht 100 ditë) ka nevojë edhe për 80 kontenierë shtesë në qoftë se marrim në konsideratë faktin që mbetjet do të grumbullohen dy here në ditë, cdo ditë të javës.

### **Pikat e grumbullimit të përkohshëm**

- Sistemi i grumbullimit të mbetjeve në njësinë administrative Velipojë do të përbëhet nga 130 kontenierë 1.1 m<sup>3</sup> ndërsa ai në Dajc nga 60 kontenierë 1.1 m<sup>3</sup>. Gjatë sezonit turistik në Velipojë do të shtohen edhe 80 kontenierë 1.1 m<sup>3</sup> për të përballuar fluksin e mbetjeve të prodhuara nga turistët. Gjatë periudhës tjetër këta kontenierë mund të tërhiqen dhe të magazinohen.
- Në pjesën e rërës do të kryhet grumbullimi i mbetjeve nga 142 kontenierë 0.25 m<sup>3</sup> të vendosura në pjesën e plazheve publike dhe private, përgjatë pedonales (privati)
- Në zonën e plazhit në qendër të Velipojës do të grumbullohen mbetjet e mbledhura në mënyrë të vecuar nga bizneset, baret dhe hotelet e lokalizuara në këtë zonë. Bizneset do të jenë përgjegjëse për grumbullimin dhe ruajtjen e mbetjeve të grumbulluar veçmas në ambientet e tyre, ndërsa firma duhet të realizojë grumbullimin dhe transportin e tyre.
- Aktiviteti i grumbullimit të mbeturinave duhet të përfshijë edhe disinfektimin e pikave të grumbullimit të mbeturinave në një reze prej 0.5 m përreth cdo pike të grumbullimit të mbeturinave (gjë që do të pengojë prezencën ose afrimin e kafshëve të ndryshme) dhe të paktën një herë në muaj edhe larjen e kontenierëve në cdo pikë të grumbullimit të mbeturinave.

### **Mirembajtja e kazaneve.**

Sipërmarresi është i detyruar që gjatë kohës së realizimit të kontratës, të mbajë inventarin e kontanierëve si dhe në mënyrë sistematike të bëjë riparimin e atyre të demtuar.

Demtimet kryesore të cilat duhet të riparohen nga sipërmarresi janë: demtimi i rrotave, kapakut dhe dorezave si dhe deformimet në trupin e kontanierit. Cdo pike grumbullimi dhe kontanieret përkatës duhet të pastrohen dhe të lahen të paktën një herë në muaj.

Sipërmarresi është i detyruar të zëvendesoje apo shtojë numrin e kontanierëve në masën 10 % cdo vit kalendarik (26 cop). Kazanet do të sillen në fund të Qeshorit dhe do të shpërndahen në të dy njesit sipas miratimit nga Drejtoria e Sherbimeve.

Kontanieret të jenë sipas specifikimeve teknike, të xinguar 1100 litrash.

### **Frekuencat e grumbullimit**

- Në njësitë administrative Velipojë dhe Dajc shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet dy here në javë, të hënën dhe të premten. Oraret e grumbullimit do të jenë herët në mëngjes ose vonë në mbrëmje, kështu do të evitohen orët me trafik.
- Për njësinë administrative Velipojë përgjatë sezonit turistik (100 dite), frekuencat dhe oraret e grumbullimit do të përshtaten në përputhje me ritjen e numrit të popullsisë. Mbetjet do të grumbullohen dy here në ditë, cdo ditë të javës. Do të punohet me dy turne dhe orët e operimit për turnin e parë do të jenë ndërmjet 14.00 dhe 16.00, ndërsa për turnin e dytë do të jenë përgjatë natës ndërmjet orës 23.00 dhe 01.00.
- Në zonën e rërës për kontenierët që do të vendosen në fund të parcelave të plazhit në kufi me pedonalen, frekuenca e grumbullimit do të jetë të paktën 3 herë në ditë, cdo ditë të javës, ndërkohë që gjatë fundjavës sipas nevojave mund të bëhet edhe 4 herë në ditë.
- Grumbullimi i rrymave të mbeturinave të grumbulluar veçmas do të kryhet një herë në javë. Të gjitha bizneset do të njoftohen për ditën dhe orën e grumbullimit.

## **Mjetet e transportit**

Kompania për të ofruar grumbullimin e mbetjeve duhet të ketë në zotërim mjetet e mëposhtme:

- makinë teknologjike me kapacitet 10 ton e cila do të punojë me dy turne në ditë për të grumbulluar mbetjet në Velipojë dhe në Dajc
- 2 makina të tjera teknologjike me kapacitet 5 ton secila, që do të punojë me dy turne në ditë vetëm për të grumbulluar mbetjet shtesë në Velipojë që prodhohen gjatë periudhës së plazhit
- 1 kamion i hapur 3 ton për të transportuar mbetjet e prodhuara në pjesën e rërës si dhe mbetjet e riciklueshme nga bizneset private në Velipojë

## **Kushtet teknike për mjetet e transportit**

- Të gjitha mjetet e transportit duhet të jenë në gjendje të mirë teknike për të mundësuar grumbullimin e mbeturinave.
- Makinat teknologjike duhet të kenë një sistem ngarkimi të përshtatshëm me kontenierët që do të përdoren në të dyja NjA.
- Sistemi mekanik i ngarkimit duhet të jetë i gjithi funksional dhe të lejojë kryerjen e nje cikli të plotë (ngritjen e kontenierit, shkarkimin dhe uljen e tij (130 kg) në një periudhë kohore të limituar prej 20 sekondash.
- Sistemi mekanik i ngritjes duhet të funksionojë vete dhe nuk duhet që puntorët të ngrenë kontenierin për ta varur atë në këtë sistem.
- Makinat teknologjike duhet të jetë në një gjendje të mire, pa rrjedhje të ndonjë fluidi, dhe në gjendje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arsye mekanike. Gjithashtu ato duhet të jetë i aftë për të lëvizur me një shpejtësi prej 80 km/h.
- Shkarkimet e gazërave të djegies nga makinat teknologjike duhet të jenë në përputhje me normat e legjislacionit në fuqi.
- Dritat e përparme dhe të pasmet duhet të jenë në gjendje të mire dhe makinat duhet të jetë gjithashtu të pajisur me reflektorë.
- Makinat teknologjike duhet të jenë të pajisur me pasqyra të jashtme për të pasur një vision

të qartë mbrapa, me mbajtëse/suport për puntorët, me sistem komunikimi (radio ose telefona) të cilat duhet të jenë të lidhura me qendrën e operimit.

- Sistemi i ngjeshjes duhet të jetë në gjendje të mirë për të lejuar një shkallë të mirë ngjeshje për të realizuar ngarkimin e sasisë së kërkuar të mbeturinave brenda volumit të kamionit (respektivisht 10 dhe 5 ton)
- Të gjitha investimet, mirëmbajtja dhe në qoftë se është e nevojshme edhe kostot e zëvendësimit të pjesëve janë të gjitha për t'u paguar nga kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e makinave teknologjike dhe për faktin që ata duhet të jenë të gjithë në gjendje pune.
- Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj. Të tilla situatë nuk duhet të kenë ndonjë influence apo ndikim mbi sasinë dhe cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.
- Makinat teknologjike duhet të lahen cdo ditë dhe të tregohet kujdes për to. Ato duhet të sigurojnë një grumbullim të sigurt, të pastër dhe higjienik të mbetjeve.
- Shoferi duhet të mbajë një libër ditor ku të tregojë të gjithë informacionin për punën e bërë cdo ditë: orën kur ka filluar grumbullimi, pushimet gjatë shërbimit, orët e shkarkimit, rrugët e bëra dhe numrin e kontenerëve të mbledhur.
- Kompania duhet të ketë gjithashtu një regjistër për cdo makinë teknologjike, ku të jepet i gjithë informacioni në lidhje me karburantin (datat, orët dhe sasinë), vajin dhe të tjera aktivitete të mirëmbajtjes.
- Në qoftë se makinat teknologjike nuk do të plotësojnë këto kërkesa, si pasojë e neglizhencës në mirëmbajtje nga kompania, atëherë njësitë administrative duhet të kërkojnë zëvendësimin e tyre.

## Fshirja e rrugëve

- Shërbimi i fshirjes së rrugëve do të aplikohet vetëm në Velipojë, në qendër të saj në zonën e plazhit. Në listën e rrugëve që do të fshihen përfshihen:
  - rruga hyrëse drejt qendrës me dy korsi me biznese në të dyja anët e saj
  - rrugët e brendshme në lulishten kryesore të qendrës si dhe
  - rruga përgjatë ndërtimeve tek kompleksi "Fishtaj"
- Në total do të fshihen 4.600.000 m<sup>2</sup> sipërfaqe rruge.
- Fshirja e ketyre rrugëve dhe shesheve do të jetë manuale, e cila nënkupton, largimin e mbeturinave, gjetheve dhe barit të lulishteve si dhe të baltës dhe plurave.
- Të gjitha materialet e mbledhura duhet të depozitohen në pikat e grumbullimit të përkohshëm të mbeturinave dhe jo të depozitohen në ndonjë vend tjetër. Kompania duhet të sigurojë që kjo rrymë mbetjesh nuk përfundon në kunetat dhe kanalet e ujrave të shiut.
- Frekuenca e fshirjes do të jetë një herë në ditë herët në mëngjes dhe do të kryhet nga puntorët sezonal me fshesa cdo ditë të javës nga e hëna deri të djelën.
- Çdo punëtor duhet të jetë i pajisur me mjete të përshtatshme të tilla si një karrocë dore, fshesa si dhe një lopatë për marrjen e mbeturinave. Punëtorët duhet të kenë veshjet e përshtatshme të punës dhe me shenjat dalluese të kompanisë.

## Personeli

- Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe dy puntorë për çdo makinë që grumbullon dhe transporton mbetjet.
- Gjatë sezonit të verës ky numër do të shtohet respektivisht për cdo mjet të përdorur (2 kamionë 5 ton dhe 1 kamion 3 ton).
- Gjatë sezonit të verës për grumbullimin e mbetjeve në hapsirat publike të plazhit të Velipojës nevojiten 10 puntorë, ndërsa për plazhet publike në Baks – Rrjoll parashikohen edhe 2 puntorë të tjerë. Kjo fuqi punëtore do të punojë me dy orare: gjatë paradites 7 – 10 dhe gjatë pasdites 17 – 20 përgjatë shtatë ditëve të javës.
- Gjithashtu do të nevojiten edhe 4 puntorë për fshirjen manuale me fshesë kryesisht në zonën e qendrës së Velipojës.
- Stafi i mësipërm do të punësohet me shpenzimet e kompanisë. Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse.

## “Edukimi Publik Mjedisor”

- Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i operatori i shërbimit për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, ndarjes së mbetjeve në burim, etj periudhës së kontratës.
- Operatori i shërbimit duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së operatori i shërbimit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambientit. Ky kontakt mund të realizohet si nëpërmjet mass-mediave ashtu edhe nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese.
- Operatori i shërbimit duhet të mundësojë shpërndarjen e materialeve informative të paktën dy herë në muaj. Materialet informative duhet të jenë në formën, fletëpalosjeve si dhe broshurave duke përfshirë në to informacione mbi shkaqet dhe shkaktarët e kësaj ndotje, parandalimin e saj si dhe masat që mund të merren për minimizimin e ndotjes. Materialet sensibilizuese duhet të jenë të tilla që të ftojnë banoret për tu bërë pjesë aktive e një shoqërie të emancipuar dhe me një edukatë mjedisore.
- Operatori i shërbimit duhet të sensibilizojë banorët nëpërmjet programit të edukimit publik mjedisor që të parkohet në përputhje me planin e ndryshimit të parkimit, në rrugë dhe ditë të caktuara, për të mundësuar fshirjen më me cilësi të këtyre rrugëve.
- Programi i edukimit mjedisor që do të bëjë operatori i shërbimit duhet të miratohet nga Autoriteti kontratues.
- Në rast se kontraktuesi nuk përmbush detyrimet e përmbushjes të edukimit mjedisor apo plotësimin të pjesshëm të tij aplikohen gjopa në masën 10.000(dhjetemije) leke/muaj.

## Monitorimi

- **Supervizoret e bashkisë** kontrollojnë shërbimin e dhënë nga kompania dhe raportojnë:

- Verifikojnë cilësinë dhe sasinë e shërbimit të ofruar nga kompania (kontenierë jo të grumbulluar, rrugë jo të fshira, kontenierë të dëmtuar, vende me grumbullim ilegal mbeturinash...etj)
- Rakordojnë vëzhgimet e tyre me përfaqësuesit e rajoneve, specialistët e njësive administrative
- I japin informacion përgjegjësit të shërbimit në bashki dhe kompanisë për cdo parregullsi apo problematike në lidhje me sasinë apo cilësinë e kontenierëve të pa grumbulluar, të pa disinfektuar, të pa larë dhe të dëmtuar apo edhe për rrugët e pa fshira si dhe për prezencën e përgjeshjeve të mbeturinave ilegale sidomos në zonën e plazhit (publik dhe privat).
- Raportojnë cdo ditë tek përgjegjësi i shërbimeve në bashki në lidhje me sasinë dhe kualitetin e shërbimit të kryer nga kompania.
- Në rast se identifikohen zëra të shërbimit të pastrimit të pa realizuar sipas preventivit të kontratës, supervizori në situacionin më të rëndësishëm për shërbimin të pakryer, kjo përveç penalteteve, sipas nenit përkatës.

### ***Kompania private***

- Kompania private është e detyruar që të mbajë cdo ditë statistika sipas pikave të mëposhtme dhe të raportojë ato tek Përgjegjësi i shërbimit në bashki në formë elektronike dhe të printuar:
- Inventari mujor i të gjitha pikave të grumbullimit të përkohshëm të mbeturinave, si dhe gjendja fizike e tyre, zëvendësimet në rast të riparimit me datat përkatëse
- Numri i kontenierëve të larë dhe të riparuar ose i kontenierëve të humbur apo të dëmtuar
- Numri i kontenierëve të ngarkuar për cdo rrugë
- Koha e shpenzuar për grumbullim për cdo rrugë të realizuar (koha e nisjes së kamionit, koha e mbushjes së kamionit, koha e nevojshme për të shkuar në landfill, koha e shkarkimit në landfill, koha e kthimit mbrapsht)
- Numri dhe intenerari i cdo makine, kilometrat e kryera nga cdo makinë transporti, nafta dhe vaji i konsumuar nga cdo makinë, si dhe operacionet e mirembajtjes për cdo makinë
- Lista e rrugëve dhe sipërfaqeve të fshira
- Sasia e mbeturinave të grumbulluara në zonën e plazhit / sipërfaqet e menaxhuara si dhe sasia e grumbulluar në mënyrë të diferencuar cdo javë
- Lista e punëtorëve dhe e orëve të punës

### **Penalitetet**

- Mos mbledhja e mbeturinave apo lënia e disa pikave të grumbullimit të pa mbledhura
  - Duhet që kompania të grumbullojë të gjitha pikat e përkohshme të grumbullimit sipas frekuencës së kërkuar dhe të përcaktuar në ToR. Supervizori i bashkisë pasi të bëjë monitorimin duhet të raportojë tek drejtori i shërbimeve në bashki, në qoftë se grumbullimi dhe largimi i mbeturinave nuk është bërë në përputhje me skedulen e dakortësuar dhe firmosur si nga bashkia ashtu edhe nga kompania private.

- Në raportin e supervizorit duhet të përmendet ora e supervizimit dhe të gjitha parregullsitë në zbatimin e procedurave të grumbullimit duke evidentuar dhe numrin e kontenierëve të pa grumbulluar për atë turn.
- Në rast të kontenierëve të pa grumbulluar atëherë kompania do të gjobitet me 5 fishin e kostos së grumbullimit dhe transportit të një kontenieri për çdo kontenier të pa grumbulluar.
- Riparimi i kontenierëve të dëmtuar dhe zëvendësimi i tyre në pikat e përkohëshme të grumbullimit
  - Kontenierët e dëmtuar duhet të zëvendësohen me kontenierë të rregullt. Është në interesin e kompanisë që të mos ketë kontenierë të dëmtuar, gjë e cila do të rriste kostot e grumbullimit.
  - Është detyra e supervizorëve të bashkisë të identifikojnë dhe të raportojnë tek kompania numrin e kontenierëve të dëmtuar të cilët duhet të zëvendësohen dhe të riparohen. Nuk duhet të lejohet që numri i kontenierëve të dëmtuar të jetë më shumë se 3% e totalit të numrit të kontenierëve (8 copë) përgjatë një jave raportim.
  - Nëse kompania nuk i tërheq për t'i riparuar dhe nuk i zëvendëson këta kontenierë të dëmtuar me kontenierë të tjerë brenda një jave që nga momenti kur ata raportohen si të dëmtuar atëherë ajo do të penalizohet me 5 fishin e cmimit të menaxhimit të kazaneve për të gjithë kontenierët e dëmtuar për të gjithë periudhën që ata nuk janë riparuar.
- Mos larja dhe mos disinfektimi i kontenierëve
  - Duhet që kompania të garantojë larjen dhe dizinfektimin e të gjithë kontenierëve sipas specifikimeve të kësaj kontrate.
  - Supervizori i bashkisë pasi të bëjë monitorimin duhet të raportojë tek drejtori i shërbimeve në bashki, në qoftë se shërbimi i larjes dhe disinfektimit nuk është bërë në përputhje me skedulen e dakortësuar dhe firmosur si nga bashkia ashtu edhe nga kompania private.
  - Në raportin e supervizorit duhet të përmendet dita dhe ora e supervizimit si dhe numri i pikave të përkohshme të grumbullimit apo sasia e kontenierëve të pa larë apo disinfektuar.
  - Në qoftë se numri i kontenierëve të pa pastruar brenda muajt është 3% e sasisë totale të kontenierëve (afërsisht 8 kontenierë) atëherë kompania do të gjobitet me 100 fishin e kostos së larjes dhe disinfektimit të një kontenieri për çdo kontenier të pa larë dhe të pa disinfektuar.
- Hedhja e mbeturinave në vende të tjera, jo në ato të përcaktuara nga bashkia (landfilli Bushat)
  - Kompania duhet të depozitojë mbetjet në landfillin e Bushatit. Ajo duhet të raportojë sasisë ditore dhe mujore të rrugëve dhe sasisë së mbeturinave të depozituara në landfillin e Bushatit.
  - Është detyra e supervizorëve të bashkisë të kontrollojnë dhe të raportojnë në lidhje me këtë aktivitet të kompanisë që ofron këtë shërbim. Në rast se identifikohen shkakime të kamioneve të kompanisë në pika të paautorizuara nga Bashkia, atëherë kompania do të penalizohet me një gjobë prej 1.000.000 lek. Gjithashtu ajo duhet që të grumbulloj,

ngarkoj, pastroj dhe të transportoj të gjitha mbetjet e depozituara në mënyrë të parregullt drejt lëndfillit të Bushatit me kostot e veta.

- Mos fshirja e rrugëve
  - Kompania duhet të fshijë të gjitha rrugët e përcaktuara në kontratë sipas frekuencave dhe orareve të dakortësuara në kontratë.
  - Nëse ky shërbim nuk realizohet qoftë sipas frekuencës së përcaktuar, orarit apo cilësisë së dëshiruar në ndonjë prej rrugëve të përcaktuara në kontratë, atëherë kompania do të penalizohet me 5 fishin e cmimit mujor për fshirjen e rrugëve.
  - Në rast se do të evidentohen hedhje të mbeturinave që vijnë nga fshirja (llumi apo sasi dherash, gjethe apo mbetje nga kopshtet) të depozituara në kunetat e kullimit atëherë kompania do të gjohet me një shumë prej 50.000 lekësh si dhe do të detyrohet të bëjë cbllokimin e tyre dhe depozitimin e këtyre mbetjeve në kontenerët më të afërt.
  
- Mungesa e raportimit ose realizimi i tij në mënyrë të gabuar
  - Kompania është e detyruar të paraqesë raporte të detajuara mujore me të dhëna statistikore në lidhje me të gjitha operacionet që ajo realizon si obligim i kësaj kontrate. Kështu kompania duhet të raportojë në lidhje me grumbullimin dhe menaxhimin e konteniereve, grumbullimin e mbeturinave nga zona e plazhit, grumbullimin e diferencuar të rrymave të vecanta, larjen dhe disinfektimin e kontenierëve, transportin e mbeturinave me të gjitha mjetet e transportit, depozitimin e mbeturinave në lëndfillin e Bushatit si dhe fshirjen e rrugëve.
  - Të gjitha raportet duhet të përputhen me punën dhe volumet e kryera në realitet nga kompania.
  - Raporti duhet të hartohet brenda dy javëve të para të muajt pasardhës dhe duhet t'i dorëzohet supervizorit të bashkisë.
  - Supervizori i bashkisë duhet të bëjë kontrollin e raportit me të dhënat që ai ka nga situacionet ditore si dhe me të dhënat e marra nga lëndfilli i Bushatit. Për cdo raport të munguar apo të vonuar apo me të dhëna jo të sakta do të shoqërohet me një gjobë e cila është një reduktim prej 3% I situacionit mujor që duhet t'i paguhet kompanisë.

Detyrimet e veçanta të kontraktuesit.

-Kontraktuesi duhet të paraqesë stafin dhe punonjësit për realizimin e kësaj sipërmarrje, si dhe me një autorizim zyrtar të paraqesë personin përgjegjës për realizimin e kontratës.

-Të këto kontrate paraprake me lëndfillin Bushat për depozitimin e mbetjeve.